

VENDIM
Nr. 656, datë 10.10.2019

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 357, DATË 24.4.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MENAXHIMIN E
DOKUMENTIT ELEKTRONIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 357, datë 24.4.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) pas pikës 4.2 shtohet pika 4.3, me këtë përmbajtje:

“4.3 Institucionet shtetërore, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duhet të sigurojnë si të vetmen mënyrë qarkullimi të dokumentit, brenda vetë institucionit, Sistemin e Menaxhimit të Dokumentit Elektronik (SMDE).”.

b) pas aneksit nr. 2, bashkëlidhur tekstit, shtohet aneksi nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe të gjitha ministratë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI NR. 3

Kryeministria
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Brendshme
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministri i Shtetit për Diasporën